



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu upravu

Nr. i prot.
10

Dt. 05.01.2026

RAHOVEC - ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Geodeziju, Katastar, i Imovinu - Sektor za imovinu

Datë/a	05.01.2026
Referencë/a	
Për/Za?To :	Z. Smajl Latifi, kryetar i Komunës së Rahovecit
CC:	Z. Fatmir Iska, nënkryetar i Komunës së Rahovecit
Përmes/Prekp/Through:	Drejtëpërdrejtë
Nga/Od/From :	Z. Afrim Oruqi, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Raporti vjetor i punës janar-dhjetor 2025



RAPORTI VJETOR I PUNËS JANAR-DHJETOR 2025

Fillimi i vitit të ri është karakterizuar me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak. Në fillim të vitit 2025 kemi punuar në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara nga kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për Vitin 2025.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të punës për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Sektori:	Lëndët:	Shuma në €
Kadastër dhe Pronë	1820	35,460€
Gjeodezi	750	25,500€
Referenti	3010+50 (L.Z.)	20,040€
Totali	5,580+50 (L.Z.)	81,000€



ВЕРХНЕУСЛУНОВСКИЙ РАЙОН
РАЙОННОЕ УПРАВЛЕНИЕ
ОБРАЗОВАНИЯ
И НАУКИ
ИЗДАНИЕ
1998 г.



Gjatë periudhës Janar-Dhjetor i kemi përfunduar këto punë:

- Pranimi i aplikacioneve të qytetarëve dhe të gjeodetëve privat për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim i pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim i paluajtshmërisë, ndarje e bashkësisë familjare etj.;
- Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje të planit;
- Barazimi financiar me drejtorinë e financave për muajt janar – dhjetor të vitit 2025;
- Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte si: koordinata, modifikime dhe punë tjera të cilat janë kryer nga sektori i gjeodetëve;
- Kemi përgatitur materialin për dhënien e pronës me qira, interes i përgjithshëm, vendim për këmbim etj.;
- Vlerësimi i punëtorëve për vitin 2024;
- Sipas afatit, lëndët i kemi pranuar dhe aprovuar me kohë në intranet;
- Përgjigje në kërkesat e personave juridik dhe fizik;
- Me kërkesë të qytetarëve/grupeve të interesit (komuniteteve) kemi përgatitur material për mbledhje të kuvendit;
- Me kërkesë të qytetarëve për falje të pronës private në pronë publike në të gjitha Zonat Kadastrale për hapje të rrugëve publike në interes të përgjithshëm, gjeodetët kanë dalë në terren dhe kemi përgatitur dokumentacionet e nevojshme për zhvillimin e këtyre procedurave;
- Dalje në terren sipas kërkesave të drejtorive përkatëse;
- Kemi mbajtur takime të rregullta me Agjencinë Kadastrale të Kosovës;
- Përgjigje në kërkesat e zyrës ligjore sipas nevojës për përfaqësime në procese gjyqësore;
- Takim me përfaqësues të USAID-it për menaxhim të mirë të pronës;
- Sipas legjislacionit në fuqi kemi përgatitur listën e veçantë dhe listën e përgjithshme të pronave, të cilat planifikojmë t'i japim me qira brenda vitit 2026;
- Ka vazhdu procesi i digjitalizimit kadastral- ri regullimi i vektorit.
- Ka fillu procesi i rindërtimit kadastral ne dy zona kadastrale në Bellacërkë dhe në Ratkoc.
- Kemi pranuar dy jurist në dy sektore një në sektorin e kadastrit dhe në sektorin pronësoresh juridik dhe
- Punë të tjera sipas kërkesave të palëve.

Me respekt,
Afrim Oruqi

Drejtore i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Komuna Rahovec

Mob: +377 (0) 45 134 006 / Ctx: +381 (0) 3820045311

E-mail adresa: afrim.oruqi@rks-gov.net

